



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:041086

Datë: 30.07.2024

Numri i dokumentit: 05998007

KPPP.nr.250/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Newco Feronikeli Complex” L.L.C., me NUI: 810507444, me seli në Glllogoc, rruga “Besim Mala Murrizi” nr.227, përfaqësuar sipas autorizimit nga shoqëria e avokatëve “SCLR Partners”, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.214/24, të datës 09.01.2024, të Përbaruesi Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Newco Feronikeli Complex” L.L.C., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.214/24, të datës 09.01.2024, të Përbaruesit Privat Eset Murati.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr.214/24, i datës 09.01.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Eset Murati.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.214/24, të datës 09.01.2024, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor - Aktvendimit të Inspektoratit të Punës Nr. 01/50-138/2023GJ të datës 15.11.2023, me të cilin është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 1,000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare,

dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit privat, si dhe regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se kreditori nuk e ka dorëzuar asnjëherë tek debitori vendimin mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarimor, i njëjti për herë të parë e ka pranuar këtë vendim së bashku me urdhrin përmbarimor, vendimi i shkallës së dytë i bashkangjitur së bashku me propozimin për përmbarim mban datën 28.04.2022, ndërsa vendimi i shkallës së parë mban datën 15.11.2023, kreditori në propozimin për përmbarim thekson se debitori ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankesë, ndërsa debitori nuk ka ushtruar ankesë ndaj këtij vendim pasi që i njëjti nuk i është dorëzuar debitorit asnjëherë. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta anuloj.

Kreditori nuk ka paraqit përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Aktvendimin Nr. 01/50-138/2023GJ të datës 15.11.2023, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Aktvendimi Nr. 01/50-138/2023GJ i datës 15.11.2023, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është*

*i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr. 01/50-138/2023GJ i datës 15.11.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarrueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase Aktvendimit Nr. 01/50-138/2023GJ i datës 15.11.2023, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 28.04.2022 dhe i ekzekutueshëm me datë 28.04.2022.

Gjykata vlerësoi pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarrimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarrimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarrimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.250/24, datë 30.07.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.